



RAPORTI I MONITORIMIT

PËR VITIN 2023

I STRATEGJISË AFATMESME TË MENAXHIMIT TË BORXHIT 2022-2026

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Shtetëror

Tiranë, Mars 2024

PËRMBAJTJA

I. Parathënie	3
II. Zhvillimet Makroekonomike gjatë vitit 2023.....	4
III. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit	5
IV. Realizimi i Objektivave të SAMB-Viti 2023	6

I. Parathënie

Raporti i Monitorimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit përgatitet në përputhje me Nenin 6 të Ligjit Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky Raport Monitorimi përgatitet nga Ministria e Financave dhe i dërgohet Komisionit për Ekonominë dhe Financat, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.

Në vitin 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përditësoi strategjinë e menaxhimit të borxhit, duke hartuar dhe publikuar Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026¹. Në ndryshim nga Strategjitë parardhëse, strategjia e re shtrihet në një horizont kohor më të gjerë, konkretisht në pesë vite. Zgjatja e horizontit kohor nga tre në pesë vite u bë për të patur një vlerësim më të plotë të analizave që strategjia mbulon si edhe favorizon një zbatim më eficient të strategjisë krahasuar me strategjitë paraardhëse të cilat mbështeteshin në një plan tre vjeçar. Nga ana tjetër, zgjatja e horizontit kohor të strategjisë, bën të nevojshme monitorimin e saj vit pas viti dhe ndërhyrjen për ta përditësuar kur vlerësohet e nevojshme, ose në të kundërt përditësimin e saj një vit përpara përfundimit të afatit kohor.

Në përputhje me Ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në muajin Mars të vitit 2023, Ministria e Financave hartoi dhe publikoi për herë të parë Raportin e Monitorimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit për vitin 2022², raport i cili paraqet një analizë mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit për vitin 2022. Në vijim, Ministria e Financave brenda tremujorit të parë të çdo viti do të hartojë një Raport Monitorimi për Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit për vitin paraardhës. Publikimi i këtij raporti do të shërbejë si një hap pozitiv në drejtim të rritjes së transparencës ndaj publikut të gjerë si dhe intensifikimit të komunikimit me investitorë apo palë të treta të interesuara.

¹ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2022/08/Strategjia-Afatmesme-e-Menaxhimit-te-Borxhit-2022-2026.pdf>

² <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Raporti-i-Monitorimit-t%C3%AB-Strategjise-Afatmesme-te-Menaxhimit-te-Borxhit-Viti-2022.pdf>

II. Zhvillimet Makroekonomike gjatë vitit 2023

Aktiviteti ekonomik deri në fund të vitit 2023 ka treguar një rezistencë mjaft të mirë ndaj goditjeve të njëpasnjëshme që kanë impaktuar vendin tonë përgjatë viteve të fundit. Ekonomia shqiptare edhe përgjatë vitit 2023 ka vijuar me një rritje pozitive dhe relativisht të lartë të aktivitetit ekonomik, të punësimit dhe pagave, pavarësisht një konteksti global të karakterizuar nga rritja e shpejtë e çmimeve, e pasigurisë dhe e kostove të financimit. Deri më tani fundamentet kryesore ekonomike dhe financiare, si dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë dhe pritet që ekonomia të vazhdojë ecurinë pozitive në periudhën afatmesme.

Ekonomia në vendin tonë është impaktuar nga zhvillimet dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian. Kushtet financiare në tregjet ndërkombëtare janë të shtrënguara duke reflektuar nivelin e lartë të normave bazë të interesit dhe presionet inflacioniste, të cilat megjithëse në ngadalësim, mbeten ende të larta. Banka Qendrore Evropiane dhe Federal Reserve kanë rritur në mënyrë të njëpasnjëshme normën bazë të interesit, rritje e cila është reflektuar dhe në rritje të kostove të financimit dhe ngadalësim në kreditimin bankar.

Përgjatë vitit 2023, pavarësisht kushteve më të shtrënguara të financimit dhe ngadalësimit të kërkesës së huaj, ekonomia shqiptare ka ruajtur trajektoren e saj pozitive dhe parashikohet të vazhdojë këtë prirje në periudhën afatmesme. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2023, PBB-ja u zgjerua me rreth 3.3%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022. Rritja është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Eksportet, si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve, veçanërisht kërkesa e huaj në sektorin e turizmit, ka pasur një ecuri mjaft të mirë ndërsa importet kanë regjistruar një normë më të ulët rritjeje. Rritja ekonomike për vitin 2023 vlerësohet të jetë rreth 3.5%, si rezultat i një sezoni veçanërisht të fuqishëm turistik, përmirësim i performancës në sektorin e ndërtimit, pasurive të paluajtshme dhe energjisë. Përsa i përket perspektivës afatmesme, rritja ekonomike parashikohet në normën 3.7% për vitin 2024 dhe mesatarisht rreth 3.9% në vit përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2024-2026.

Inflacioni përgjatë vitit 2023 ka shënuar një nivel mesatar vjetor prej 4.8%, duke vijuar trendin rënës. Trendi rënës i inflacionit u diktua nga dobësimi i presioneve të huaja inflacioniste, nga forcimi i kursit të këmbimit të lekut, si dhe nga impakti i kursit normalizues të politikës monetare. Për rrjedhojë, Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë normalizuese monetare gjatë vitit 2023 duke rritur normën bazë të interesit me rreth 0.5 pikë përqindje, përkatësisht nga 2.75% në fund të vitit 2022 në 3.25% në fund të vitit 2023, duke diktuar një rritje të lehtë të normave të interesit të depozitave dhe kredive.

Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2024-2026, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit

makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Gjatë periudhës afatmesme, politika fiskale do të vazhdojë të targetojë një trajektore rënëse të përvitshme të borxhit publik, që vetëm përgjatë vitit 2023, vlerësohet të ketë shënuar një rënie 5.2 p.p., duke arritur në nivelin prej 59.2% të PBB dhe pritet të vijojë të bjerë më tej në rreth 58.1% në vitin 2024.

III. Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit

Ministria e Financave përditësoi Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, Strategji e cila u miratua nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet VKM me Nr. 534, datë 29.07.2022 “Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026”. Aktualisht kjo Strategji është në fuqi dhe monitorohet në mënyrë të rregullt vit pas viti, deri në përfundim të afatit kohor të saj.

Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2022-2026 është në funksion të objektivave të përgjithshme të menaxhimit të borxhit të specifikuar në ligjin Nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si edhe është në linjë me kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal dhe me politikat monetare të Bankës së Shqipërisë.

Kjo Strategji mbulon menaxhimin e Borxhit të Qeverisjes Qendore, në të cilin përfshihet Borxhi Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore të Huasë. Qëllimi i saj është të orientojë huamarrjen drejt instrumenteve me kosto të favorshme dhe me nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj riskut për nivele të caktuara të financimit. Nivelet e financimit përcaktohen në kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal dhe në Planin Afatmesëm Buxhetor të ndarë në plane/volume vjetore të huamarrjes.

Në hartimin e Strategjisë janë marrë në konsideratë raportet kosto-risk të portofolit ekzistues si dhe zhvillimi i këtyre raporteve bazuar në një analizë sasiore të realizuar për një numër skenarësh (strategji) alternativë të financimit, shkalla e ekspozimit të borxhit ndaj risqeve dhe shkalla e zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë. Krahas strategjisë bazë, e cila i referohet skenarit më të mundshëm të financimit, në Strategjinë e Menaxhimit të Borxhit janë parashtruar edhe tre strategji alternative financimi, duke vlerësuar për çdo rast ndikimet e mundshme mbi kostot, risqet dhe shkallën e zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë.

IV. Realizimi i Objektivave të SAMB-Viti 2023

IV.1 Ecuria e objektivave të përgjithshme të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026.

IV.1.1. *Plotësimi i nevojave të qeverisë për financim në kohë, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve*

Viti 2023 ka qenë një vit mjaft pozitiv për sa i përket sigurimit të financimit, si në tregun e brendshëm dhe në atë të huaj. Huamarrja u realizua në përputhje me Planin Vjetor të Huamarrjes për vitin 2023 si edhe në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026. Gjatë vitit 2023, huamarrja në terma bruto u realizua në vlerën 466.0 miliard Lekë, nga të cilat 80.3% (ose 374.1 miliard Lekë) u financuan nëpërmjet burimeve të brendshme dhe 19.7% (ose 91.9 miliard Lekë) nëpërmjet burimeve të huaja.

Tabela 1: Realizimi i Huamarrjes


Burimet e Huamarrjes	2022		2023	
	Vlera (në mld Lekë)	%/Total	Vlera (në mld Lekë)	%/Total
Burime të Brendshme	357.9	92.7%	374.1	80.3%
Bono Thesari	245.5	63.6%	225.6	48.4%
Obligacione	112.3	29.1%	148.5	31.9%
Burime të Jashtme	28.3	7.3%	91.9	19.7%
Hua për financimin e projekteve	11.2	2.9%	9.4	2.0%
Mbështetje Buxhetore	17.1	4.4%	19.7	4.2%
Eurobond	-	0.0%	62.8	13.5%
Total Huamarrja	386.1	100.0%	466.0	100.0%

Burimi: *Ministria e Financave, 2024*

Qeveria emtoi 374.1 miliard Lekë tituj shtetërorë në tregun e brendshëm, nga të cilët 225.6 miliard Lekë Bono Thesari dhe 148.5 miliard Lekë Obligacione.

Në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2023 është rritur frekuenca dhe vlera e emetimeve të instrumenteve afatgjata dhe si rrjedhojë borxhi i ri është mundësuar tërësisht nëpërmjet titujve afatgjatë, si edhe është shoqëruar me maturime të instrumenteve afatshkurtër. Kërkesa për tituj shtetërorë ka qenë më e lartë se oferta e Qeverisë pothuajse në të gjitha ankandet e realizuara gjatë vitit dhe huamarrja neto në tregun e brendshëm në fund të vitit 2023 rezultoi 20.8 miliard Lekë. Nga totali i financimit neto, 41.8 miliard Lekë financim neto është realizuar nëpërmjet obligacioneve, ndërsa sa i takon instrumenteve afatshkurtër, financimi neto rezulton negativ prej -20.9 miliard Lekë, që do të thotë se gjatë vitit 2023 janë maturuar instrumente afatshkurtër më shumë se sa janë emtuar.

Grafik 1: Huamarrja e brendshme neto muaj pas muaji³



Burimi: *Ministria e Financave, 2024*

Sa i takon burimeve të jashtme të financimit, huamarrja gjatë vitit 2023 u realizua në nivelin prej 91.9 miliard Lekë. Huamarrja e huaj është realizuar nëpërmjet emetimit të instrumentit të Eurobondit dhe disbursimit të huave për projekte dhe mbështetje buxhetore. Në Qershor 2023, Qeveria emetoi Eurobondin e gjashtë me një vlerë prej 600 milion Euro, kupon 5.9%, yield 6.125% dhe me një ofertë finale (*final book*) prej 1.3 miliard Euro. Gjithashtu gjatë vitit 2023 janë disbursuar mbështetje buxhetore me terma të favorshme në vlerën totale rreth 185 milion Euro nga insitucionet financiare ndërkombëtare dhe partnerët bilateral si Banka Botërore, KfW dhe AFD. Pjesa tjetër e huamarrjes është realizuar nëpërmjet disbursimit të kredive për financimin e projekteve kryesisht në, transport, infrastrukturë urbane, si dhe furnizim me ujë dhe kanalizime.


Kosto

Për sa i përket raporteve të koston dhe riskut në portofolin e borxhit, portofoli i borxhit është arritur të menaxhohet në mënyrë të përshtatshme, duke mbajtur koston në nivelin më të ulët të mundshëm sipas kushteve të tregut, ndërkohë indikatorët e riskut kanë shfaqur përmirësim në të gjithë treguesit.

Për vitin 2023, shpenzimet për interesa të borxhit përllogariten në vlerën prej 47.6 miliard Lekë, përkatësisht 29.0 miliard Lekë për interesa të borxhit të brendshëm dhe 18.6 miliard Lekë për interesa të borxhit të jashtëm. Ripagesat e borxhit të jashtëm për vitin 2023 ishin 53.2 miliard Lekë (pagesa për principalin). Krahasuar me vitin 2022 shpenzimet për interesa u rritën me 8.0 miliard Lekë (20.1% më shumë se viti 2022), kryesisht si rezultat i rritjes së normave të interesit në tregun e brendshëm dhe atë të huaj. Rritja e shpenzimeve për interesa ka qenë brenda parashikimeve dhe në përputhje me Projektbuxhetin e Vitit 2023.

³ Është llogaritur financimi neto për çdo muaj i ndarë nga muajt paraardhës.

Grafik 2: Shërbimi i Borxhit 2018-2023



Burimi: Ministria e Financave, 2024

IV.1.2. Përmirësimin dhe ruajtjen e efikasitetit të tregut primar, mbështetur nga zhvillimi i mëtejshëm i tregut sekondar të titujve shtetërorë vendas

Në ndryshim nga viti 2022, i cili u karakterizua nga një pasiguri në tregun primar vendas si dhe ulje të kërkesës për tituj shtetërorë, gjatë vitit 2023 situata u përmirësua ndjeshëm dhe kërkesa për tituj shtetërorë u rikthye në nivele të kënaqshme, duke tejkaluar ofertën e Qeverisë për tituj shtetërorë. Raporti i mbulimit ka qenë mbi 1 pothuajse në të gjithë ankandet e realizuara si në kategorinë e titujve afatshkurtër dhe në kategorinë e titujve afatgjatë. Kërkesa për tituj shtetërorë ka vazhduar të mbështetet tek investitorët vendas (rezidentë), ndërkohë që sektori bankar mbetet burimi kryesor i kërkesës me mbi 60% të peshës.

Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës së tregut primar dhe stimulimit të tregut sekondar, kanë vazhduar të ndërmerren aktivitete, të cilat kanë pasur si objektiv reduktimin e fragmentimit të kërkesës, si dhe konsolidimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë. Titujt referencë 3 dhe 5 vjeçar janë emetuar me sukses në dy linja emetimi gjatë vitit 2023: konkretisht Obligacioni referencë 3 vjeçar është emetuar në shumën totale 27.3 miliard Lekë dhe Obligacioni referencë 5 vjeçar është emetuar në shumën totale 34.1 miliard Lekë.

Në drejtim të krijimit të madhësive *benchmark* është vijuar me konsolidimin e numrit të ankandëve të titujve shtetërorë, duke ulur frekuencën e emetimeve të titujve të rinj dhe duke përdorur rihapjet e titujve ekzistues. Në total gjatë vitit 2023 janë realizuar 98 ankande, nga të cilët 41 ankande për tituj afatshkurtër, 51 ankande për tituj afatgjatë dhe 6 ankande buyback (blerje mbrapsht) për titujt referencë 3 dhe 5 vjeçar.

IV.1.3. Zhvillimi i tregut të titujve shtetërore

Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë është synuar të realizohet nëpërmjet aktiviteteve të cilat kishin si objektivi: a) rritjen e likuiditetit; b) rritjen e efikasitetit; dhe c) rritjen e transparencës.

Realizimi i objektivave të mësipërme është një synim afatgjatë, ndërkohë që zhvillimi i aktiviteteve dhe marrja e masave të ndryshme është një proces i cili ka filluar dhe do të vijojë të kryhet dhe fuqizohet më tej në vazhdimësi. Konkretisht, gjatë vitit 2023, Ministria e Financave ka realizuar për herë të parë vlerësimin për 5 bankat zhvilluese të tregut për vitin 2023. Ky vlerësim është kryer në zbatim të Metodologjisë për Vlerësimin e Bankave Zhvilluese të Tregut (Udhëzim i Ministrit të Financave nr. 30, datë 07.11.2022). Qëllimi i këtij dokumenti është përshkrimi i metodologjisë standarde që ndjek Ministria e Financave në kuadër të vlerësimit dhe monitorimit periodik të performancës së veprimtarisë së 5 bankave zhvilluese të tregut (Market Maker) lidhur me titujt shtetërorë referencë. Vlerësimi i veprimtarisë së këtyre bankave ndihmon në zhvillimin e mëtejshëm të tregut të titujve të Qeverisë, nxitjen e tregut sekondar dhe rritjen e likuiditetit. Rezultatet e vlerësimit në bazë të kësaj metodologjie, janë paraqitur në një raport të konsoliduar për vitin 2023, i cili është ndarë paraprakisht me ekspertë të fushës të Bankës Botërore për komente dhe sugjerime dhe në vijim do të diskutohet me bankat pjesëmarrëse.

IV.1.4. Hartimi dhe publikimi i një plani vjetor huamarrje

Ministria e Financave, për të dytin vit radhazi, hartoi dhe publikoi në muajin Dhjetor 2023 Planin Vjetor të Huamarrjes për vitin e ardhshëm, konkretisht për vitin 2024⁴. Plani Vjetor i Huamarrjes për vitin 2024, synon të mbështesë aktivitetin e huamarrjes vjetore të Ministrisë së Financave, si dhe të rrisë transparencën kundrejt investitorëve dhe palëve të treta të interesuara.

Plani Vjetor i Huamarrjes jep në mënyrë të detajuar instrumentet që do të perdoren në tregun e brendshëm, emetimet përkatëse sipas çdo instrumenti si edhe frekuencën e emetimit të çdo instrumenti. Gjithashtu, Plani Vjetor i Huamarrjes detajon dhe huamarrjen në tregun e huaj, duke specifikuar vlerën e huamarrjes së huaj për vitin 2024, si edhe instrumentet që do të perdoren në tregun e huaj. Bazuar në Planin Vjetor të Huamarrjes të vitit 2024, do të hartohen dhe kalendarët tremujorë të huamarrjes në tregun e brendshëm. Gjithsesi, theksojmë se, Ministria e Financave rezervon të drejtën që të mund të ndryshojë frekuencën apo shumën e emetuar për instrument/muaj duke ju përshtatur kushteve aktuale të tregut.

⁴ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/Plani-Vjetor-i-Huamarrjes-2024.pdf>

IV.1.5. Vlerësimi i mundësisë së përdorimit të alternativave të reja të burimeve të financimit (Green, Sociale etj)

Në vazhdim të nismës së iniciuar gjatë vitit 2022, edhe gjatë vitit 2023, Ministria e Financave ka vlerësuar mundësitë e përdorimit edhe të alternativave të reja të financimit, përveç burimeve tradicionale të huamarrjes. Për këtë arsye, janë organizuar disa takime me përfaqësues të Bankës Botërore për sa i përket detajeve të këtyre instrumenteve avantazheve/disavantazheve, mundësinë e implementimit, procedurat dhe kushtet për implementimin e tyre etj.

Në kushtet ku këto lloje instrumentesh paraqesin një tërësi të panjohurash, Ministria e Financave do vijojë të eksplorojë në drejtim të njohjes sa më të plotë të parakushteve, benefiteve dhe përshtatshmërisë apo gatishmërisë së vendit tonë për të avancuar me iniciativa të emetimit në tregjet e kapitalit të instrumenteve të financimit green apo sociale. Banka Botërore është ofruar të asistojë Ministrinë e Financave dhe strukturat e tjera relevante, në thellimin e vlerësimeve në këtë drejtim.

Nga këndvështrimi mjedisor dhe social, Ministria e Financave ka ndërmarrë hapa konkrete në drejtim të sigurimit të një ndërgjegjësimi më të lartë të impaktit mjedisor dhe social, me rishikimin e procedurave të menaxhimit të investimeve publike. Në muajin dhjetor 2022 janë miratuar nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Vendimit Nr. 887 datë 27.12.2022, procedurat e reja të menaxhimit të investimeve publike, të cilat, në tërësinë ë përmirësimeve që sjellin në këtë fushë, parashtrojnë një qasje të avancuar sa i takon impaktit mjedisor, klimaterik dhe atij social të projekteve të investimeve. Çdo projekt i mundshëm investimi që synohet të financohet, do të vlerësohet duke konsideruar gjithashtu, si një element/parim të rëndësishëm, edhe vlerësimin mjedisor dhe impaktin klimaterik.

Tabela 2: Ecuria e Objektivave të Përgjithshme

	Objektiva të përgjithshme cilësore	2022	2023	2024	2025	2026
1	Plotësimi i nevojave të qeverisë për financim në kohë, si edhe nevojave për të shërbyer borxhin aktual me kosto sa më të ulët duke mbajtur nivele të pranueshme të ekspozimit ndaj risqeve	✓	✓			
2	Përmirësimin dhe ruajtjen e efikasitetit të tregut primar, mbështetur nga zhvillimi i mëtejshëm i tregut sekondar të titujve shtetërorë vendas	✓	✓			
3	Zhvillimi i tregut të titujve shtetërorë	✓	✓			
4	Hartimi dhe publikimi i një plani vjetor huamarrje	✓	✓			
5	Vlerësimi i mundësisë së përdorimit të alternativave të reja të burimeve të financimit (Green, Sociale etj)	Në Proces	Në Proces			

Burimi: *Ministria e Financave, 2024*

IV.2. Ecuria e objektivave specifike sasiore të Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2022-2026.


Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit synon të përmirësojë më tej strukturën e borxhit (*kryesisht strukturën e portofolit të borxhit të brendshëm*), në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, si dhe mbajtjes së kostos në nivelet më të ulëta të mundshme, bazuar në kushtet aktuale të tregut. Gjatë vitit 2022, në kushtet e shtrënguara të tregjeve, huamarrja ishte jo e lehtë për tu realizuar dhe në rrethanat e një kërkesë të orientuar kryesisht drejt instrumenteve afatshkurtra, treguesit e riskut nuk shënuan përmirësim krahasuar me vitet e mëparshme. Ndërkohë, viti 2023 ka qenë një vit mjaft pozitiv sa i përket ecurisë së huamarrjes, dhe si rrjedhojë indikatorët e riskut kanë shfaqur përmirësim në të gjitha kategoritë krahasuar me fundin e vitit 2022, si edhe gjithashtu kanë shfaqur përmirësim krahasuar me vitin bazë të strategjisë, vitin 2021, pavarësisht përkeqësimit të ndodhur gjatë 2022.

Risku i Rifinancimit

Një ndër objektivat kryesore të SAMB është reduktimi i riskut të rifinancimit kryesisht në portofolin e borxhit të brendshëm, pasi borxhi i jashtëm paraqet më pak risk duke qenë se është i përbërë nga instrumente me afat të gjatë maturimi dhe me profile amortizimi të shtrira gjatë në kohë. Gjatë vitit 2023, në përputhje me Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, Ministria e Financave ka rritur peshën e emetimeve të instrumenteve afatmesme dhe afatgjata në tregun e brendshëm dhe si rezultat, treguesit e riskut të rifinancimit kanë shfaqur përmirësim të ndjeshëm krahasuar me fundin e vitit 2022, si edhe gjithashtu kanë shfaqur përmirësim krahasuar me vitin bazë të Strategjisë (vitin 2021). Konkretisht, jetëgjatësia e borxhit të brendshëm (ditët mesatare në maturim) është rritur me 55 ditë, nga 780 ditë në fund të vitit 2022 në 835 ditë në fund të vitit 2023, ndërkohë që krahasuar me fundin e vitit 2021 ky tregues është rritur me 42 ditë (DMM në fund të vitit 2021: 793 ditë).

Gjithashtu, pesha e borxhit që maturohet brenda një viti është ulur nga 47.9% në dhjetor 2022 në 44.7% në dhjetor 2023. Njëkohësisht, ky tregues është në përmirësim krahasuar me vitin bazë të SAMB, ku në fund të vitit 2021 ishte 46.6%.

Grafik 3: Treguesit e Riskut të Rifinancimit




Burimi: Ministria e Financave, 2024

Risku i Normave të Interesit

Risku i normave të interesit, gjithashtu ka shfaqur përmirësim gjatë vitit 2023, kjo në rrethanat e përdorimit të shtuar të titujve afatmesëm dhe afatgjatë si edhe emetimit vetëm të titujve më norma interesi fikse në tregun e brendshëm. Konkretisht, pesha e borxhit që rivlerëson normën e interesit brenda vitit është ulur ndjeshëm nga 49.0% në fund të vitit 2022 në 45.4% në fund të vitit 2023. Ky tregues është në përmirësim edhe krahasuar me vitin bazë të SAMB, ku vlerësohej në nivelin 48.0%.

Gjithashtu, edhe koha mesatare në rifiksion është rritur nga 2.17 vite në fund të vitit 2022 në 2.33 vite në fund të vitit 2023. Ky tregues është përmirësuar ndjeshëm krahasuar dhe me vitin bazë të Strategjisë, duke qenë se në vitin 2021 ky tregues është vlerësuar në nivelin 2.19 vite.

Grafik 4: Treguesit e Riskut të Normave të Interesit




Burimi: *Ministria e Financave, 2024*

Risku i Kursit të Këmbimit

Risku i kursit të këmbimit është mbajtur nën kontroll duke qëndruar nën tavanin e përcaktuar në strategji. Konkretisht, totali i stokut të borxhit në valutë ndaj stokut të borxhit total rezultoi 45.4% në fund të vitit 2023, duke u ulur me 1.4 p.p krahasuar me fundin e vitit 2022, si dhe është ulur me 4.4 p.p, krahasuar me fundin e vitit 2021, një përmirësim i ndjeshëm. Gjatë vitit 2023 ky tregues është ndikuar kryesisht nga nënçmimi i pjesës më të madhe të valutave të huaja, kryesisht Euros dhe USD, kundrejt Lekut.

Grafik 5: Risku i Kursit të Këmbimit



Burimi: *Ministria e Financave, 2024*

Tabela 3: Indikatorët e Riskut

Objektiva specifike sasiore	Baseline 2021	Objektivi Strategjik 2026	Viti i Raportimit-2023			
			Statusi 2022	Statusi 2023	Aktivitetet	Komente
Përmirësimi i Riskut të Rifinancimit						
KMM borxhi i brendshëm (vite)	2.20	Min 2.5	2.17	2.32	Parashikuar një huamarrje e mbështetur gjithnjë e më tepër në tituj afatmesëm dhe afatgjatë.	Gjatë vitit 2023 u mundësua ajo mbështetje e synuar në tituj afatmesëm dhe afatgjatë që garantoi përmirësim tek treguesit e riskut
Borxhi i brendshëm që maturohet në 1 vit (% të totalit)	46.6%	Max 40%	47.9%	44.7%		
Përmirësimi i Riskut të Normave të Interesit						
KMR borxhi i brendshëm (vite)	2.19	Min. 2.5	2.17	2.33	Parashikuar huamarrje vetëm me instrumenta me normë fikse interesi.	Huamarrja u realizua vetëm me instrumenta me normë fikse.
Borxhi i brendshëm norma e të cilit rifiksohet në 1 vit (% të totalit)	48.0%	Max 43%	49.0%	45.4%		
Përmirësimi i Riskut të Kursit të Këmbimit						
	49.8%	Max. 50%	46.8%	45.4%	Parashikuar që burimet e huaja të shërbejnë si plotësues të burimeve të brendshme.	Ky tregues është ndikuar kryesisht nga nënçmimi i pjesës më të madhe të valutave të huaja, kryesisht Euros dhe USD, kundrejt Lekut

Burimi: *Ministria e Financave, 2024*